



Nr. Ref. BD-205/1

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.4 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datat 04 dhe 05 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Autoritetit të Likuidimit shpërndarjen e përkohshme e pjeshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IGK Ballkan PRZ -14 (në Likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.
- II. Rezervimet për ankesa në përqindjen 27% apo në shumë totale 268,218.14€ do të bëhen në bazë të Memorandumit të mirekuptimit me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës MMPHI për pagesën e shpronësimit të NSh IGK Ballkan ashtu që kësti i rradhës që do të aguhet do të dedikohet për rezervimin e ankesave.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të pjesëshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IGK Ballkan PRZ -14 (në Likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjeshme të fondeve të Likuidimit të NSh IGK Ballkan PRZ -14 (në Likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.


Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 04 korrik 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-205/2

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Nenit 10. 1.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datat 04 dhe 05 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e OJQ Anibar për shfrytëzim pa kompensim, i hapësirës së katit të I-rë të objektit të vjetër të NSh Bankos, në Pejë, për periudhën 15-31 korrik 2024.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Borði i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për shfrytëzimin e hapësirës së objektit të vjetër të NSh Bankos, në Pejë.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin me datë 03 korrik 2024 Agjencia ka pranuar kërkesën nr .protokoli 2661 nga z. Vullnet Sanaja, Drejtor Ekzekutiv i Festivalit të Filmit të Animuar Anibar, përmes së cilës kërkohet shfrytëzimi e hapësirës së objektit të vjetër të NSh Bankos në Pejë, respektivisht katin e I-rë të objektit. Qëllimi i shfrytëzimit të hapësirave afariste është organizimi i aktiviteteve kulturore për periudhën 15- 31 korrik 2024. Kjo OJQ është e angazhuar në zhvillimin e kinematografisë dhe promovimin e prodhimit Kosovare, zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet promovimit të shfaqjes së filmave në kinema të mbyllura dhe të hapura dhe organizimet e festivaleve ndërkombëtare të filmit të animuar dhe artistik, etj.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi konform nenit 10.1.3 i Rregullores nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ,shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 04 korrik 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

